

STATUT
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" Best Call 2021 "

KREUI
Themelimi, Emri, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit.

(1) Sot, me 10/09/2021, ne themeluesit , kemi krijuar nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emrin " **Best Call 2021** " .

(2) Themelues i shoqerise " **Best Call 2021** " shpk eshte :

Znj. Denada Meta, atësia Bashkim Tafa, e datëlindjes 02/02/1992, lindur ne Tirane, Shqipëri, dhe banues ne Shqipëri, shtetas i Republikës se Shqipërisë, mbajtës i kartës me numër personal J25202066M te lëshuar ne Shqipëri;

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria " **Best Call 2021** " Shpk, është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, e cila nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri ne pjesën e pashlyer te kontributeve te nënshkuara Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendrën Kombëtare te Biznesit, ne përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi te ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj te tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjate veprimtarisë se saj.

Neni 3

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresen:, Rruga 4 Deshmoret, Zona Kadastrale Nr.5370, Nr Pasurie.7/392-N1, Tirane.

Adresa e shoqerise per qellime te komunikimit elektronik eshte (nese ka):

Shoqëria mund te ndryshoje selinë e saj, te hape zyra, përfaqësi, dege, filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, me vendim te Asamblesë se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i aktivitetit te shoqërisë

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë është ne fushën si vijon:



Ofrimi, mbështetja dhe operimi i shërbimeve telefonike. Importimi, tregtimi dhe mbështetja teknike i pajisjeve telefonike dhe celulare dhe materialeve të telekomunikacionit. Prodhimi dhe përpunimi, promovimi dhe tregtimi i mallrave dhe shërbimeve telefonit, shtypit elektronik dhe të shkruar, operimi i shërbimeve informatike, Ofrimi i shërbimeve të trajnimit dhe konsultimi në çështjet telekomunikacionit. Furnizim shërbimesh dhe informacioni nëpërmjet telekomunikacionit. Import-eksport tregtim i mallrave të ndryshëm.

Neni 5

Kohëzgjata

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10 000 Leke i përbërë nga gjithsej 1 kuote.

Kapitali themeltar është nënshkruar dhe zotërohet nga

1. Denada Meta, zotëruese e 1 kuote, që përben 100% të kapitalit në vlerën 10 000 Leke.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- 9) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakeve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga transferimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotës, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratoreve;
- 9) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "9" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblesë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje të tjera Si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- 9) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;


Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga administratori.

Administrator i shoqërisë është znj. Denada Meta, e cila do të ushtroj funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejte ripërtëritje.



Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejte e detyrohet të:

- a) kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 9) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mënyrë vajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- f) të çelë llogari bankare, të kryeje derdhje, transferime, tërheqje bankare, të përfaqësojë shoqërinë pranë Bankave.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretet e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretet nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është prove e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asamblëja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te përcaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirëbesim e ne interesin me te mire te shoqërisë ne tërësi, duke i kushtuar vëmendje te veçantë ndikimit te veprimtarisë se shoqërisë ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetëmpër arritjen e qëllimeve te përcaktuara ne këto dispozita;

c) te vlerësojë me përgjegjësiçështjet, për te cilat merret vendim;

9) te parandaloje dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo te mundshëm, te interesave personale me ata te shoqërisë;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne mënyre te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vlerësimit te informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te këtij neni, është i detyruar dëmshpërblejeshoqërisë demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga këto veprime te parregullta. Administratori ka barrën e provëspër te vërtetuar kryerjen e detyrave te tyre ne mënyre te rregullt e sipas standardeve te kërkuara. Kur shkelja është kryer nga me shume se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë ne mënyrë solidare.

4. Ne mënyrë te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejeshoqërisë demet e shkaktuara, nëse, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare me ndryshimet, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

9) lejon qe shoqëria te vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqëria nuk do te kishte aftësi paguese për te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrënë padi penale kundër administratorit . Paditësit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshire edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund ta ndaloje ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera përgjatë ushtrimit te detyrës.

Kapitulli IV

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shpërndarjes se disidentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Dividendi

Te ardhurat neto (Dividendi) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mësipërme dhe te atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te tretëve, i mbeten dhe i kalojnë ne pronësi te ortakeve.

Neni 16

Prishia dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund te behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblesë se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë.
- d) me vendim te gjykatës;

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojnëmënyrën e likuidimit te shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër"

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim te rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim përemërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për te caktuar një likuidues.

Neni 17

Likuiduesi merr përsipër te drejtat e detyrimet e administratoreve nga data e emërimit te tij. Nëseshoqëriaemëron me shume se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnëveçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnëbashkërisht te drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mundte autorizojnënjërin prej tyre te kryeje veprime te një kategorie te posaçme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u ku drejtohen te tretëve, ne përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes se ortakut dhe administratorit.

Neni 18

Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqërisë, mbledhja e kredive te pa arkëtuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqërisë dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, për mbylljen e një veprimi te papërfunduar.

3. Nëse, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit " Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme përpagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc te gjendjes se shoqërisë ne çastin e hapjes se likuidimit dhe një bilanc përfundimtar ne çastin e mbylljes se këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat me shume se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqërisë. Bilancet ne

shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortaket e tjerë, ndërsa ne shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësite kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 19

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare te Regjistrimit përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, ne përputhje me ligjin.

Neni 20

Bashkimi

Dy ose me shume shoqëri mund te bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit te gjitha aktiveve e pasiveve te njëres ose me shume prej shoqërive, qe quhen shoqëritë e përthithura, te njëshoqëritjetër ekzistuese, e quajtur shoqëriapërthithëse, ne këmbim te aksioneve apo kuotave te kësajshoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit te njëshoqërie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, qe bashkohen ne këmbimte aksioneve apo kuotave teshoqërisë se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i njëshoqërie te re.

Neni 21

Ndarja

1. Njëshoqëri mund te ndahet me vendim te Asamblesë se Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqërive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqëria qe ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Shoqërite, qe fitojnëpasuritë e shoqërisë qe ndahet, quhen shoqëripritës edhe përgjigjen ne mënyre solidare për detyrimet e kësaj te fundit.

3. Regjistrimi i ndarjes se shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit ka si pasoje:

a) kalimin te shoqëritë pritëse te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqërisë qe ndahet, ne përputhje me raportin e ndarjes, te përcaktua ne marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionareve/ortakeve te shoqërisë qe ndahet aksionare apo ortake te një ose me shume shoqërivepritëse, ne përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar ne marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit pa kryerjen e likuidimit.

Neni22

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshoje formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj ne shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqëria ka marr përsipër ndaj te tretëve.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne ketë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe

Shoqëritë tregtare" te ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe përçdomosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua ne 2 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike, ne gjuhen shqipe pasi miratohet ne parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare nënshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e saj origjinale.

ORTAKU I VETEM

Denada META

Denada Meta

